



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. _____ prot.

Fier, më 15.07.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje rakorderish /prizash /gurnicionesh /tubacionesh /lagështuesish për gazet mjekësore ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): priza dhe spina.

VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 1 351 733,33 (një million e treqind e pesëdhjet e një mijë e shtatëqind e tridhjet e tre.33) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4,
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** te fundit **(2022, 2023, 2024)**, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 400 000 lekë**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedrat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet **tatimore** brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 : Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **200 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate).

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilin është e percaktuar se: [...] 4. (b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) për secilin artikull.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtësin e autorizimit për tregëtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kriteri 2.3.3: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributori të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesë vetedeklarim me shkrim.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqip).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021.

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” neni 21 i tij.

Kriteri 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim i lëshuar, i vlefshëm për vitin 2025 nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe është në përputhje me objektin e kontratës. Është patur parasysh se bombulat e oksigjenit duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

Kriteri 2.3.6 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë dhe/ose skedë teknike për mallrat e ofruara. Në katalogë/skedë teknike, specifikimet teknike të mallit duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas specifikimeve teknike të kërkuara. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST (Dokumentet duhet të jenë të përkthyer dhe të motorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar si dhe plotëson kërkesat e AK.

Kriteri 2.3.7 : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve të ofruar duhet të paraqesë certifikatën SSH EN ISO 13485:2016 “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për tregëtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Kriteri 2.3.8 Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklarate që furnizuesi nga i cili siguron mallrat objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë **ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** ose EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i

vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi për kriterin 2.3.7 dhe 2.3.8 :Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Specifikimet Teknike:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia e kërkuar
1	Bombul oksigjeni 10 L e kompletuar(reduktor,lageshtues set)me një got rezerv secila	copë	5
2	Bombul Oksigjeni 5 L L e kompletuar(reduktor,lageshtues set)me një got rezerv secila	copë	6
3	Kompletuar(reduktor,lageshtues set) për bombul 2L	copë	1
4	Kompletuar(reduktor,lageshtues set) për bombul 5L	copë	1
5	Kompletuar(reduktor,lageshtues set) për bombul 10 L	copë	1
6	Priza oksigjeni murale	copë	20
7	Lagështues oksigjeni mural	copë	10
8	Gota kavanoza vakumi	copë	10

Operatori ekonomik duhet të ketë:

- ✓ Çertifikata ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”
- ✓ Të gjitha materialet të nënshtrohen kërkesave të ligjit 89/2014 “Për paisjet mjekësore” I ndryshuar
- ✓ Autorizim për tregëtim të paisjeve mjekësore,të lëshuar nga MSHMS,sipas ligjit 89/2014 “Për paisjet mjekësore” I ndryshuar.

Gjithashtu:

- ✓ Bombulat e oksigjenit duhet të jenë të mbushura me oksigjen mjekësor të gaztë ,oksigjeni mjekësor I gaztë I përdorur në bombula duhet të jetë I regjistruar ,dhe të plotësojnë kushtet teknike të paisjeve nën presion .

- ✓ Për këtë të paraqitet vërtetim i lëshuar, i vlefshëm për vitin 2025 nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion, conform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet sipas DST-se.

Argumentimi: janë vendosur bazuar te procesverbalit nr. 438/4 date 26/06/2025 te komisionit te hartimit i specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje rakorderish /prizash /gurnicionesh /tubacionesh /lagështuesish për gazet mjekësore ”, si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT: